



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI I INTEGRIMIT EUROPIAN

Nr. 9796 prot

Roskovec, më 19.11.2025

PROJEKT-VENDIM

NR ____ .DATË 19.11 2025

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË BINJAKËZIMIT MIDIS BASHKISË
ROSKOVEC, SHQIPËRI DHE KOMUNËS SË URURIT, ITALI

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, të drejtat dhe përgjegjësitë, pika 1.5. “Të drejtën e bashkëpunimit”, paragrafi b) bashkëpunojmë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe të përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi; si dhe Vendimin Nr. 734, datë 09.09.2015 “Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore” pikat 9 dhe 11/c; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshillit të Bashkisë Roskovec.

Ju paraqesim për diskutim dhe miratim:

1. Fillimin e Procedurës së Binjakëzimit midis Bashkisë Roskovec dhe Komunës së Ururit (Itali).
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec për nënshkrimin e marrëveshjes së binjakëzimit midis Bashkisë Roskovec dhe Komunës së Ururit Itali
3. Ngarkohet për zbatim pas miratimit të këtij projekt-vendimi, Sektori i Integrimit European, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë.

Konceptoi: *U.Blido*

Pranoi: *N.Pelivani*

Për Drejtorinë Juridike: *V.Zeqo*

KRYETAR
Majlinda Bufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI I INTEGRIMIT EUROPIAN

Nr. 796/prot
1

Roskovec, më 19.11.2025

Lënda: Relacion për projektvendimin “Për miratimin e procedurës së binjakëzimit midis Bashkisë Roskovec dhe Komunës së Ururit Itali”.

KËSHILLIT BASHKIAK

Roskovec

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, të drejtat dhe përgjegjësitë, pika 1.5. “Të drejtën e bashkëpunimit”, paragrafi b) bashkëpunojmë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe të përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi; si dhe Vendimin Nr. 734, datë 09.09.2015 “Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore” pikat 9 dhe 11/c; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshillit të Bashkisë Roskovec.

Paraprakisht është zhvilluar në datën 30 korrik 2025 në Bashkinë Roskovec takimi midis Nënkryetarit të Komunës Arbëreshe së Ururit Z.Emiliano Plescia dhe Asistentit të tij Z.Michelle Altobello dhe Kryetares së Bashkisë Roskovec Znj.Majlinda Bufi. Takimi filloj me pritjen në zyrën e Kryetares së Bashkisë ku pati një diskutim të hapur mbi njohjen e dy qyteteve, si dhe forcimin e lidhjeve midis komuniteteve arbëreshe dhe atyre shqiptare duke frymëzuar një marrëdhënie të re bashkëpunimi. Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i ideve dhe eksplorimi në fusha të tilla si kultura, arti, arsimi, trashëgimia kulturore dhe zhvillimi lokal. Më pas takimi vijoi me një vizitë në Muzeun e Historisë Vendore të Roskovecit, duke u njohur me trashëgiminë historike dhe kulturore të Roskovecit, për të vijuar me vizitën në Kishën e Shën Kollit në Kurjan.

Në vijim të takimeve është zhvilluar edhe një vizitë studimore në Ururi, bazuar edhe në kërkesën për fillimin e procedurës së binjakëzimit me Nr.Prot 7377, datë 03.09.2025 u zhvillua në datën 17 tetor takimi me Kryetaren e Bashkisë së Ururit Znj.Laura Greco dhe

Nënkryetarin e Bashkisë Z.Emiliano Plescia si edhe përfaqësues të tjerë të komunitetit Arbëresh ku u diskutua mbi ruajtjen e identitetit dhe trashëgimisë kulturore. Vizita pasoi me njohjen e strukturave përbërëse të Bashkisë së Ururit si Salla e Këshillit, Biblioteka "Maria Teresa Marinelli", Muzeu i Garave me Qe. Bazuar në kërkesën për nisjen e procedurave të binjakëzimit midis Bashkisë Roskovec dhe Komunës së Ururit në Itali, palët kanë konfirmuar interesin e tyre të ndërsjellë për krijimin e një partneriteti institucional. Pas marrjes së dakordësisë në parim edhe nga Komuna e Ururit do të vijohet me hapat ligjor për binjakëzimin, sipas procedurës standarte si vijon:

- Hartimin dhe miratimin nga Këshilli Bashkiak të procedurës së bashkëpunimit
- Marrjen e mendimit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë
- Negocimin dhe dakordësimin e një Memorandumi Mirëkuptimi (MoU) mes dy palëve
- Nënshkrimin zyrtar të marrëveshjes së binjakëzimit nga Kryetari i Bashkisë Roskovec dhe homologut nga Komuna e Ururit
- Hartimin e planit të përbashkët të aktiviteteve për zbatimin e marrëveshjes

Arsyet e binjakëzimit janë:

- Nxitjen e shkëmbimeve kulturore dhe sociale
- Promovimin e traditave, vlerave historike dhe identitetit lokal Arbëresh
- Krijimin e mundësive për projekte të përbashkëta në fusha si kultura, arsimi, rinia, bujqësia, dhe zhvillimi ekonomik
- Forcimin e marrëdhënieve mes komuniteteve, duke përfshirë komunitetin shqiptar në Itali.

Qëllimet e binjakëzimit midis dy bashkive

1. Forcimi i marrëdhënieve miqësore

- Vendosja e lidhjeve të qëndrueshme institucionale dhe komunitare.
- Krijimi i një partneriteti afatgjatë midis dy bashkive.

2. Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira

- Ndërveprime profesionale mes administratave vendore.
- Transferimi i njohurive në planifikim urban, shërbime publike, teknologji, transparencë dhe mirëqeverisje.

3. Promovimi i kulturës dhe trashëgimisë

- Nxitja e shkëmbimeve kulturore, artistike dhe folklorike.
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore dhe festive.

4. Zhvillimi ekonomik dhe turistik

- Mbështetja e iniciativave për zhvillim lokal ekonomik.
- Promovimi i turizmit, agroturizmit dhe resurseve natyrore të të dy bashkive.
- Krijimi i mundësive për sipërmarrje dhe investime.

5. Bashkëpunimi në arsim dhe rini

- Marrëveshje shkollore, shkëmbime nxënësish e mësuesish.
- Projekte të përbashkëta rinore dhe sportive.
- Kampuse verore dhe vizita studimore.

6. Bashkëpunimi në fushën e bujqësisë dhe mjedisit

- Shkëmbime teknike në bujqësi, agropërpunim, ushqim dhe siguri ushqimore.
- Projekte për mbrojtjen e mjedisit, energjitë e gjelbra dhe menaxhimin e mbetjeve.

7. Forcimi i lidhjeve me diasporën

- Përfshirja e komuniteteve shqiptare jashtë vendit në projektet lokale.
- Ruajtja e gjuhës, identitetit dhe traditave.

8. Zhvillimi i projekteve të përbashkëta

- Hartimi i projekteve të financuara nga BE, organizata ndërkombëtare ose donatorë të tjerë.
- Rritja e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e projekteve.

9. Nxitja e solidaritetit dhe bashkëpunimit humanitar

- Ndihma reciproke në raste emergjencash, fatkeqësish natyrore ose situatash humanitare.

Rezultatet e pritshme nga ky bashkëpunim për Bashkinë Roskovec janë:

- Zhvillimi kulturor dhe social, përmes shkëmbimeve të vazhdueshme mes dy komuniteteve;
- Mundësi për projekte të përbashkëta në fusha si kultura, agro-turizmi, arsimi, sporti dhe zhvillimi rural;
- Rritja e profilit ndërkombëtar të Bashkisë Roskovec dhe afrimi me praktikat bashkëkohore të administrimit lokal në BE;
- Fuqizimi i lidhjeve me diasporën shqiptare në Itali, duke përfituar në aspektin social, ekonomik dhe identitar;
- Transferimi i njohurive dhe përvojave të mira administrative.

Për të formalizuar këtë bashkëpunim, është e nevojshme miratimi i procedurës së binjakëzimit nga Këshilli Bashkiak. Miratimi i projekt-vendimit për procedurën e binjakëzimit krijon bazën ligjore dhe institucionale për një partneritet të qëndrueshëm dhe të dobishëm midis Bashkisë Roskovec dhe Komunës së Ururit, Itali.

Kjo nismë përputhet me politikat zhvillimore të Bashkisë, me strategjitë kombëtare të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe sjell përfitime të drejtpërdrejta për komunitetin.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Konceptoi: *U. Blido*

Pranoi: *N. Pelivani*

KRYETAR
Majlinda Buqi